



PROJEKT VENDIM

Nr., datë2024

PËR

**PËRCATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR MARRJEN
E MASAVE PARANDALUESE PËR PËRHAPJEN E ZJARREVE NË
TOKA BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16/1, pika 7, të Ligjit nr.9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave;

VENDOSI:

1. Ndalohet djegia e masës bimore, pjesëve të tyre apo mbetjeve bimore, në tokat bujqësore, vreshta, pemëtore, kullota, shkurre dhe ferra me përjashtim të rasteve kur bazuar në urdhrin e autoritetet kompetente për arsye që lidhen me shëndetin e bimëve në përputhje me legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e bimëve, mjedisit dhe mbrojtjes civile.
2. Në rastet e lejuara nga legjislacioni, djegia kryhet në një zonë të kufizuar dhe të veçuar dhe jo mbi të gjithë sipërfaqen e cila nuk kalon 5 përqind të sipërfaqes së parcelës.
3. Djegia e mbetjeve bimore nuk kryhet nëse materialet janë të ndotura, kanë substanca të rrezikshme, konservues, regjës, veshje të tjera artificiale, lëndë druri, pemë, mbetje nga krasitja e pemëve, gjethe, ashkla ose mbetje të tjera të ngjashme të krijuara nga praktikat bujqësore.
4. Në procesin e djegies nuk përfshihen mbetje të kopshteve, parqeve, varrezave dhe mbetjet që dalin nga punimet e zhvillimit infrastrukturor, apo mbetje të tjera që nuk janë mbetje bimore nga ferma.
5. Djegia e masës bimore në tokat torfike është e ndaluar.

6. Në rastet e ndezjes së zjarreve në tokat bujqësore, në pronësi private apo shtetërore, nga data 1 prill, deri më 30 nëntor të çdo viti, pronari apo përdoruesi i saj, paraqesin në njësitë e vetëqeverisjes vendore, kërkesë për kryerjen e këtij procesi, e cila përmban:
 - a. Të dhënat kadastrale të ngastrës në të cilën do të ndizet zjarri.
 - b. Sipërfaqja e tokës ku do të ndizet zjarri.
 - c. Shkaqet e ndezjes së zjarrit.
 - ç. Argumentimi agronomik i shkaqeve të ndezjes së zjarrit.
 - d. Lloji i bimësisë që do të digjet,
 - dh. Data dhe ora e ndezjes së zjarrit.
 - e. Masat mbrojtëse të marra prej tij, për mbrojtjen nga zjarri.
 - ë. Pëlqimin/miratimin me shkrim nga pronarët kufitarë të tokës bujqësore, të vërtetuar nga Kryetari i fshatit.
7. Njësitë e vetëqeverisje vendore :
 - a. bëjnë verifikimin në terren të ngastrës në të cilën do të ndizet zjarri;
 - b. paraqesin kërkesën në organet për shërbimet e mbrojtjes civile, në të cilën argumentohet nevoja e ndezjes së zjarrit, përcaktohet bimësia që do të digjet dhe garantohet përmbushja e kushteve sipas pikës 5 të nenit 16/1, të ligjit nr.9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokë bujqësore”, të ndryshuar,
 - c. lëshojnë lejen e ndezjes së zjarrit, pas marrjes së lejes nga shërbimet e mbrojtjes civile, ku specifikohen:
 - i. emri i personit apo personave që marrin përsipër veprimin e djegies;
 - ii. vendndodhja e sipërfaqes që do të digjet, datën dhe periudhën kohore kur do bëhet djegia;
 - iii. analiza e përmbushjes së kushteve sipas pikës 5 të nenit 16/1 të ligjit nr. 9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar;
 - iv. data dhe ora e ndezjes së zjarrit;
 - v. pëlqimi me shkrim prej pronarëve ose përdoruesve të ngastrave në kufi me ngastrën ku do të kryhet djegia;
 - vi. masat e detyrueshme të marra nga personi përgjegjës dhe organet e qeverisjes vendore për mbrojtjen nga zjarri.
 - ç.përcaktojnë specialistin e zyrës së mbrojtjes së tokës që do të mbikëqyrë kryerjen e ndezjes së zjarrit.
8. Shërbimet e mbrojtjes civile, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve sipas pikës 5 të nenit 16/1 të ligjit nr.9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, lëshojnë lejen ku përshkruhen masat parandaluese që

zjarri të mos dalë jashtë kontrollit, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimet.

9. Djegia e masës bimore mbi sipërfaqen e tokave bujqësore, vreshtave, pemëtoreve, shkurreve e ferrave, në çdo rast duhet të bëhet vetëm nëse nis pas orës 8.00 dhe përfundon para orës 18.00.
10. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësitë e Vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A